

VEPRIMTARIA E URDHRI TË FARMACISTEVE TË SHQIPËRISË**PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2016**

Bazuar në Neni 7 të Ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH” i ndryshuar, po iu dërgojmë raportin për veprimtarinë e 6-të mujorit të parë të UFSH-së për vitin 2016, sipas sektorëve përkatës.

Spektori i Antaresimit dhe Regjistrimit

Spektori i Antaresimit dhe Regjistrimit, e ushtron veprimtarinë e tij, në mbështetje të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar; neni 4, 5 dhe 6 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit Nr. 10171, dt. 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Veprimtaria e Sektorit të Antaresimit dhe Regjistrimit pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë për periudhën Janar- Qershor 2016 është si më poshtë:

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2016, pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë janë paraqitur gjithsej 203 aplikime për anëtarësime të reja. Spektori i anëtarësimit dhe regjistrimit të farmacistëve, pasi ka konstatuar vërtetësinë e dokumentacionit, ka proceduar me plotësimin e certifikatës së re të anëtarësimit dhe ka bërë dorëzimin e saj tek personi përkatës. Nga këto 203 anëtarësime të reja, rezulton se 185 figurojnë si anëtarësime aktive, të punësuar, ndërkohë 18 anëtarësime të reja janë në gjendje pasive, sipas listës bashkëngjitur këtij raporti.

Bazuar në Regjistrin Themeltar Kombëtar të anëtarëve të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, në formë elektronike dhe manuale, deri në fund të qershorit 2016 na

rezultojnë gjithsej 2242 farmacistë në gjendje aktive, prej të cilëve 1509 drejtues teknik dhe 733 si farmacistë të punësuar. Në këtë periudhë rezultojnë gjithashtu 125 farmacistë të cilët janë të dypunësuar.

Duke u bazuar në problematikën e Qendrës Kombëtare të Licensimit, në lidhje me farmacistët, të cilët në regjistrat e kësaj qendre vazhdojnë të figurojnë si drejtues teknik në më shumë se një subjekt, si rrjedhojë e faktit që raportimet në lidhje me ndryshimet përkatëse, mund të bëhen vetëm nga pronari I subjektit; Urdhri I Farmacistëve të Shqipërisë, Sektori i Anëtarësimit dhe Regjistrimit të farmacistëve për ti ardhur në ndihmë këtij institucioni me informacione të përditësuara, që nga muaji shtator 2015, raporton cdo muaj në lidhje me ndryshimin e pozicionit të punës për secilin drejtues teknik.

Një nga shqetësimet e ngritura në mënyrë të herëpashershme pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ngelet problemi i ndihmës farmacistëve, të cilët e ushtrojnë profesionin në farmaci. Këta të fundit nuk ricertifikohen për shkak se Ligji i ri i Barnave e ka përjashtuar këtë kategori, dhe nga moment i hyrjes në fuqi të Ligjit dhe deri më sot nuk ka asnjë akt tjetër nënligjor që të përcaktojë sesi do të procedohet.

Edhe sot e kësaj dite ky shqetësim nuk ka gjetur një zgjidhje.

Duke marrë parasysh faktin se preken një numër i konsiderueshëm ndihmës farmacistësh, do të kërkonim një reagim sa më të shpejtë në mënyrë që ti jepet zgjidhje këtij problemi.

Sektori i Mbikëqyrjes Profesionale

Në kuadrin e problematikës që ka Shërbimi Farmaceutik, me qëllim ruajtjen dhe garantimin e cilësisë së Shërbimit Farmaceutik, Ju bëjmë me dije, raste të vërejtura nga ana jonë, të cilat janë kthyer në fenomene shumë shqetësuese që çenojnë rëndë cilësinë e

këtij shërbimi dhe njëkohësisht jetën dhe shëndetin e pacientit, për eliminimin e të cilave kërkojmë ndërhyrjen Tuaj dhe të Institucioneve që Ju drejtoni.

Lidhur me sa më sipër, Urdhri I Farmacistëve të Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon Ligji Nr. 9150, Date 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë, i ndryshuar, në mbikëqyrjet e ushtruara në Subjekte të ndryshme Farmaceutike për periudhën Shkurt - Qershor 2016, ka vërejtur këto shkelje ligjore në subjektet e mëposhtme:

1. Në qytetin e Elbasanit, në Lagjen Luigj Gurakuqi, u gjend një farmaci (**Sole 1**) e cila rezulton pa drejtues teknik. Në farmaci u gjend duke shërbyer një person jo farmacist.
2. Në qytetin e Librazhdit, përballë spitalit, ushtron veprimtarinë një farmaci e cila rezulton pa drejtues teknik, e quajtur (Poli), në të cilën shërben një person jo farmacist.
3. Në qytetin e Tiranës, në rrugën e Dibrës, në farmaci (**Deshati**), u gjend duke shërbyer një praktikante.
4. Në qytetin e Tiranës, në rrugën Mine Peza, në farmaci (**Gerta**), u gjend një person jo farmacist.
5. Në qytetin e Tiranës, Rr. Sami Frashëri, Nr. 9, Tiranë, në farmaci (**Livida 1**), u gjend duke shërbyer studente e vitit të pestë farmaci.
6. Në qytetin e Tiranës, në rrugën e Kavajës, në farmaci (**Seti**), u gjend duke shërbyer një person i diplomuar për farmaci, por nuk ka kaluar me sukses provimin e shtetit.

Të gjitha këto raste janë në proces në Komisionin Disiplinor të Gjykimit Profesional.

Urdhri I Farmacistëve të Shqipërisë me shqetësim ngre problemin në lidhje me farmacitë sezonale të hapura në zonat bregdetare. Nga verifikimet paraprahe që ka bërë Urdhri I Farmacistëve, në të shumtën e rasteve rezultojnë që këto farmaci e ushtrorjnë aktivitetin e tyre pa asnjë document apo certifikatë regjistrimi dhe pa personel farmacist të certifikuar nga Urdhri I Farmacistëve. Prandaj do të kërkonim ndërhyrjen tuaj dhe një verifikim të

situatës në këto zona për ndërprerjen e veprimtarisë së paligjshme dhe vëniën para përgjegjësisë ligjore të personave që rrezikojnë jetën e popullatës duke dhënë një shërbim për të cilin nuk janë të kaulifikuara.